

# Rishikimi i serisë kohore të treguesve të Llogarive Kombëtare, 1995-2018

**Tiranë, më 27 Mars 2025:** Instituti i Statistikave (INSTAT) publikon serinë kohore të rishikuar, të treguesve të Llogarive Kombëtare, si në vijim:

- Serinë kohore të rishikuar, të Produktit të Brendshëm Bruto, 1995-2018, me **metodën e prodhimit dhe të shpenzimeve**, në terma vjetorë;
- Serinë e re kohore, të PBB, 2013-2018, me **metodën e të ardhurave**, në terma vjetore;
- Serinë kohore të rishikuar, të PBB, Tr.1 2001-Tr.4 2018, me **metodën e prodhimit**, në terma tremujorë;
- Serinë kohore të rishikuar, të PBBTr.1 2008 -Tr.4 2018 me **metodën e shpenzimeve**, në terma tremujorë;
- Serinë e re kohore të PBB, Tr.1 1995 -Tr.4 2000, me **metodën e prodhimit**, në terma tremujorë;
- Serinë e re kohore të PBB, Tr.1 1995-Tr.4 2007, me **metodën e shpenzimeve**, në terma tremujorë;  
linku: [Llogaritë Kombëtare \(GDP\) | Instat](#)
- Serinë e re kohore, të **Llogarive Jofinanciare sipas Sektorëve Institucionalë**, 2013-2018, në terma vjetorë, linku: [Llogaritë Vjetore sipas Sektorëve Institucional | Instat](#);

Plotësimi i serisë kohore, 1995-2024, të treguesve kryesorë, të Llogarive Kombëtare, në frekuencë vjetore dhe tremujore, përbën një hap të rëndësishëm që Instituti i Statistikave (INSTAT) ka realizuar në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë, për integrimin në Bashkimin Evropian. Në përbushje të një prej rekomandimeve kryesore për Kapitullin 18 "Statistikat", INSTAT ka plotësuar serinë kohore prej vitit 1995.

Ky përditësim është realizuar në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikat e Harmonizuar për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike (HERP), sipas ESA 2010.

Për të dhëna të detajuara mbi rishikimin e seriesë kohore 1995-2024 të Llogarive Kombëtare viziton Databazën e INSTAT [PxWeb - Select table](#).